

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.01.2024*

15.01.2024

Ora 11:04

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë zotit Plarent Pjetër Ndreca”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë:

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite shqyrtimin e projektvendimit që ka të bëjë me dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Qarkut Tiranë, për shkak të vakancës së krijuar në Kuvendin e Shqipërisë. Po!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e mungesës pa arsye për mbi 6 muaj rresht në Kuvend, të deputetit zotit Arben Ahmetaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në datë 25.4.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.01.2024*

shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfitur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë. Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfitur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 22, zoti Plarent Ndreca, i cili ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 38601/1. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, rezulton se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, zotin Plarent Ndreca, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit zotit Arben Ahmetaj, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë i renditur me numër rendor 22, zotit Plarent Ndreca.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.01.2024*

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, meqenëse pas verifikimeve të kryera në lidhje me kandidatin e radhës zotin Plarent Ndreca nuk verifikohet që të ekzistojnë kushtet për moszgjedhjen e tij si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, vendos:

- Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, zotit Plarent Pjetër Ndreca.
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
- Mirë faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 07

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*